

## DËSHMI PËR SHQIPTARËSINË E REKËS SË EPËRME

Fatmir SULEJMANI<sup>1</sup>

<sup>1\*</sup> Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

\*Corresponding author e-mail: fatmir.sulejmani@unite.edu.mk

---

### Përmbledhje

Rekën, që nga shënimet e Pukëvilit, e gjejmë të banuar me popullatë shqiptare - me burra dinjitozë e me *tigra të luftës malore*, për të cilët kanë shkruar historianë të shumtë. Kjo është faqja e dokumentuar e një të vërtete, anën tjetër të së cilës e përbën tema tabu e asimilimit tinëzak të njerëzve të kësaj krahine, të cilën e çelëm pas një shekulli të plotë heshtjeje prej peshku. Reka e Epërme, që si sinor shtrihet në të dy anët e Radikës, midis kurorave malore të Korabit e Deshatit, ka qenë përherë zemra e Shqiptarëve ortodoksë, të cilët gjer vonë e kanë ndier veten si pjesë të tërësisë së kombit.

Por, lënia pas dore e Rekës dhe tjetërsimi i dhunshëm i shqiptarëve në sllavë, i filluar nga Jugosllavia e Versajit dhe e finalizuar nga Maqedonia socialiste si pjesë e Jugosllavisë së Avnojit, e ka shkretuar rajonin dhe i ka shprazur gati në tërësi fshatrat e banuar me popullatë shqiptare të krishterë dhe muslimane, si: Zhirovica, Grekaj, Vërbeni, Vërbjani, Tanusha, Rimnica, Nivishta, Zhuzhnja, Shtirovica, Reçi, Strezimiri, Brodeci, Niçpuri, Bogdeva, Krakornica, Dubova, Vollkovia, Senca, Tërnica, Mavrova, Nikifori, Kiçinica, Beliçica, Lemnova, Brezovica, Çajani, Dufi. E veçanta e procesit të shndërrimit të shqiptarëve ortodoksë në sllavë brenda disa dekadash, është asimilimi i heshtur i mijëra rekasve dhe indiferenca e shqiptarëve të tjerë, që gjithashtu e bënë sehir pabëzajtur gjëmën e vëllezërve biologjikë. Ndaj, aq sa flet kjo vaki për metodat e sofistikuar të asimilimit në fjalë, po aq ndriçon edhe ndërgjegjen tonë kolektive, gatishmërinë për t'ua shkruar në asgjë me *lehtësi të papërballueshme*.

---

### Beteja e Josif Bagerit kundër asimilimit të shqiptarëve të Rekës

Të merremi vesh: ajo që humbëm dje nuk mund t'na kthehet kurrë si e tërë, por mjafton ta njohim e ta kuptojmë tragjedinë e madhe që pësoi një krahinë e rëndësishme shqiptare, siç e kuptoi para 100 vitesh Josif Bageri, i cili bëri të pamundurën për të shpëtuar rekasit nga shfytyrimi i përsijetshëm. Ai e vuajti si askush tjetër shterjen e katundeve të Rekës dhe këtë u mundua ta ndalojë me përpjekjet kundër përçarjeve ndërvellazërore, në baza krahinore e religjioze. Hullitë ndarëse i luftoi me elementet përbashkuese: vijën e gjakut, farës dhe atdheut.

Për këto ideale Bageri mori shumë goditje, por nuk u mposht kurrë, as e morri inat atdheun shkaku i hirës së huaj të infliltruar në të gjitha sferat e jetës. Ngado që shkonte thoshte: "Nëse vdes, *eshtrat t'mi çoni 'n'Shqypni, atje në Rek!*". Atij s'i bënte pët syri edhe kur ua thoshte serbëve: "Ju doni të ndreqni një Serbi të re në tokat e Shqipërisë së vjetër". Gjatë stinës më të rrezikshme të asimilimit barbar të bashkëkombasve, Prometeu Josif Bageri i këndoi me zjarrmi Gjuhës shqipe - gjuhës së gjyshnisë, gjuhës lindore, gjuhës sonë natyrale.

Ai ishte optimist dhe besonte se do të vijë një ditë kur, pavarësisht ndasive fetare, burrat dhe gratë e fisme do ta shpëtojnë Rekën nga kthetrat e tjetrit dhe nga injoranca e mjeranëve shqipfolës, pinjollët e të cilëve akoma sot nuk e kanë të qartë rëndësinë e ndërjegjësimit dhe kthimit të shqiptarëve ortodoksë në gjirin e etnisë biologjike, jo për t'i bërë dëm dikujt, por për ta vënë në vend të drejtën e Zotit dhe për t'ia bërë me dije botës se Reka ka qenë, është dhe do të mbetet shqiptare. Josif Bageri punoi tërë jetën për ta njohur botën me të vërtetën e Rekës së Epërme. Por i vetëm nuk ia doli të ndalë procesin e asimilimit të kësaj krahine prej pushtuesve egërshanë, që i tjetërsuan shqiptarët ortodoksë, po nuk arritën ta vrasin në tërësi idenë e lirisë në shpirtin e rekasve. Veçmas nuk arritën ta fshehin të vërtetën e shqiptarësisë së Rekës, që për poetin e saj rilindës ishte *Kërthiza e Shqypënis*.

### **Vepra që zbardh të vërtetën e Lumës së Epërme**

Në vijën e përpjekjeve për të shpërfaqur të vërtetën e sipërpërmendur është monografia "*Luma e Epërme*" e Burim Prroit, që ndriçon pothuajse të gjitha aspektet e rëndësishme të jetës së njerëzve të Rekës së Epërme (sipas autorit: Lumës së Epërme), nga e shkuara e largët gjer në kohën tonë. Vlerën e e veprës në fjalë e rrit edhe fakti se është shkruar nga një bir i shquar i saj, i cili me të drejtë thotë se: "*Asnjëherë kalimtari i huaj apo fqiu nuk mund ta njohë shtëpinë e dikujt më mirë se vetë pronari*". Duke qenë se vepra është shumë e gjerë, kurse hapësira që kemi në disponim e kufizuar për të folur rend-me-rend për gjithë thesaret e saj, po sjell në mënyrë të përmbledhur disa ngjarje të rëndësishme për të cilat shkruan autori i shkathtë me pedantërinë e një shkencëtari të mirëfilltë.

Kështu, përpos toponimeve dhe mikrotoponimeve karakteristike të fshatrave të Lumës së Epërme, që janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për të dëshmuar përkatësinë etnike të popullatës së kësaj krahine, Burim Prroi sjell të dhëna impesive për të shkruarën e lavdishme dhe të tashmen e dhimbshme të këtyre viseve, për shtrirjen gjeografike, për mënyrën e jetës dhe mbijetesës së njerëzve nën shputa pushtuesish të egër, për shkollimin dhe arsimimin, për besimet fetare, për fiset shqiptare të krishtera dhe të muslimanizuara, për lidhjet e tyre farefisnore, për njerëzit e shquar, për familjet e mëdha dhe të pasura, për fermerët e përmasave të pazakonta, për krimet dhe aktet gjenocidale të pushtuesve - djegiet dhe rrënimet e fshatrave, vjedhjet dhe sekuestrimet e pronave dhe bagëtive, persekutimet, vrasjet, përdhosjet e varreveve dhe tempujve të vjetër të kultit.

Flet për ndarjet e familjeve nëpërmjet asimilimit fetar e etnik, pasojat e konvertimit dhe përçarjet e nxitura nëpërmjet klerikëve antikombëtarë, migrimet, shpërnguljet e dhunshme, vendet/fshatrat ku janë vendosur banorët e shpërngulur, trajtimin e njerëzve si robër, shfrytëzimin e tyre me punë të rënda "vullnetare" si ndërtues hekurudhash, digash e hidrocentralesh. Flet për shkaqet e rrënies graduale të numrit të nxënësve nëpër shkollat shqipe, pozitën e rekasve në periudhën e pushtimit osman, në periudhën e luftërave ballkanike, rolin destruktiv të fuqive të mëdha, Luftën e Dytë Botërore, periudhën e pushtetit komunist jugosllav, rolin e rekasve në konfliktin e vitit 2001, kontributin e diasporës për ringjalljen e Lumës së Epërme, për t'u mbyllur me veçantitë e të folmes së Lumës së Epërme, përkatësisht me kapitullin, të cilin autori e ka huazuar nga libri "*E folmja shqipe e Rekës së Epërme*", të Sejfedin Harunit, të botuar në vitin 1994.

Vlerën e veprës së Burim Prroit e rrisin të dhënat e dëshmuara nëpërmjet referencave të pafundme, dokumenteve zyrtare të periudhave të ndryshme historike, hartave të vjetra gjeografike, tabelave mbi lëvizjet demografike, statistikave mbi regjistrimet e hershme e të vonshme të familjeve dhe popullatës së Lumës së Epërme, procesverbaleve të mbledhjeve e konferencave vendore e ndërkombëtare në të cilat janë miratuar vendime të kombshme për shqiptarët, listave me të ftuarit për kryerjen e shërbimit ushtarak në ish shtetet jugosllave, listave me të rënë në luftërat e ndryshme, listave me të burgosurit në kazamate pushtuesish, faqeve të

gazetave, traktateve mbi copëtimet e ricopëtimet e trojeve tona, dokumenteve arkivore, fotografive rrëqethëse të familjeve shqiptare që shpërnguleshin nga Reka në Turqi, gojëdhëna e dëshmime të gjalla të shkularakëve, vargjeve elegjiake popullore, pasaportave, vesikave, krimeve të dokumentuara në faqe gazetash të huaja, dokumenteve zyrtare që shpalojnë pretekstet për sllavizimin e Rekës, preteksteve për burgosjen dhe likuidimin e shqiptarëve, listave me shqiptarë të pushkatuar nga OZN-a jugosllave, fletoreve zyrtare me emrat e të pushkatuarve, të dhënave statistikore me numrin e të shpërngulurve më dhunë dhe shumë dëshmime të tjera që e shndërrojnë librin në një enciklopedi të mirëfilltë për Lumën e Epërme.

## **Emrat e familjeve, fiseve dhe toponimet e Rekës**

Në vijim do të ndalemi tek emrat familjeve e fiseve dhe në toponiminë interesante të fshatrave të Rekës, që nuk lënë vend për dyshime lidhur me përkatësinë etnike të popullatës së saj, të cilën më kot përpiqen ta shtrembërojnë pseudohistorianët albanofobë. Të dhënat janë shkëputur nga kapitulli i parë i monografisë së Burim Prroit dhe jepen këtu përmbledhtas, pa përmendur fshatrat të cilave u takojnë familjet, fiset, lumenjtë, përrojet, burimet, arat, zabelet, faltoret...

**Po e nisim me disa emra fisesh dhe familjesh rekase, si:** Cukala, Kovaçi, Karabashi, Bojku, Doku, Krraku, Lulexhi, Krosi, Çaja, Karakorri, Ugrini, Bregu, Mire, Bele, Kola, Struka, Vele, Sharku, Shandani, Siraku, Allamaçi, Merdudi, Gegaj, Trodaj, Kolcaku, Vataj, Dokuzaj, Lika, Dushaj, Gaxhaj, Manolaj, Abrashaj, Papazi, Kacipula, Borboshi, Pura, Tushaj, Gordi, Dekle, Revanasi, Sormaxhiu, Xhutkaj, Lomaj, Bregzaj, Fuçkaj, Gacaj, Palaj, Mlikaj, Pandaj, Bashkaj, Nuskaj, Luçkaj, Brajku, Bylykbashi, Boguçi, Çapeku, Çikrameni, Toska, Ballabani, Tolaj, Bezaveci, Çajani, Vreskalla, Stamballarët, Leshkallarët, Strukallarët, Veshallarët, Metallarët, Pishallarët, Tanallarët, Xherballarët, Pejçamllarët, Karajanallarët, Karaxhovllarët, T'Simes, T'Krases, T'Sapllamllit, T'Ismailit, T'Mojoses, T'Miles, T'Zhinkut...

**Po kaq shqiptare janë dhe toponimet dhe mikrotoponimet e vendbanimeve të kësaj krahine të moçme, si:** Bregu i Madh, Kroi i Pervanës, Pemt e Celes, Livadhi i Lançes, Livadhi i Tanes, Proi Lulishtes, Buneci i Vogel, Buneci i Madh, Guri i Kupes, Kroi i Ftohet, Ball Fusha, Kroi i That', Guri karshi Kiçenices, Te mproin xhenazet, Viset N'dushk, Guri i Ligjavecit, Kisha e Shumpremtes, N'bregna, N'livadhe T'bregut, Te Kroi i Shethun, Ligaçeci, Rrafsha e Litit, Bregu i Izvirit, Gropa e Minçes, Lugu i Trimes, N'lug T'jazit, Guri i Zhypit, Kroi i Peces, Guri i Damonit, Molla e Ombel, Mullini i Stojanit, Mullini i Kishës, Kisha e Dingozit, Mashnat e Pesh Markut, Kroji i Priftit, Kroji i Pejes, Kroji i Miles, N'vorra, Bjeshka e Vogel, Biguri, Kroi i Vaut, Ligata e Madhe, Tumba, Procka, Bunari, Shpella e Helves, Shpella e Shiravices, Livadhet e Kishës, Livadhi i Fackes, Livadhi Mullinit, Ara e Qorrit, Ligata e Shorrit, Guri i Çat, Shpella e Ahmet Sherretes, Skundroi, Brestavica, Kroi i Kalltanës, Livadhi i Shemes, Guri i Sabris, Dardha e Madhe, Kroji i Ftohet, Kumlla e Rendit, Shpija e Priftit, Ara e Priftit, Shulloni, Livadhi i Hajdarit, Dardha e Madhe, Prroji i Panes, Rrahi i Alis, Rrahi i Ivanit, Ura e T'Boves, Kroji i Verrinjes, Llombi i Nedelkut, Guri i Stomit, Guri i Vërllakut, Lenishta, Bregu i Botës, Vorret e Tujshve, Guri i Shypes, Guri i Çpuet, Kroji i Kusarit, Vorret e Mdha, Kalibat e Zhypve, Vorret te Xhamija, Kroji i Askerit, Kroji i Marenës, Guri i Shytes, Kroji i Arifit, Ura e Krysh, Guri i Velpnes, Mullini i Sahis, Kishëvica, Livadhet, Kroji i Mitres, Kroji i Ravanit, Llofkat e Hysen-Jovanit, Pralluga, Çadrat, Molla e Candit, Dera e Karabit, Zabeli, Kukuli, Ura e Zhabes, Klenja, Ura e Poshtë, Ura e Epër, Vrani, Ligata e Vranit, Guri i Zhypkes, Stozhi, Allnishti, Gurzi Bushavica, Kroji i Pqakes, Gropat e Korsit, Proji i Bukavenit, Guri ma

Gurit, Livadhet e Buta, Kodra e Shallavortit, Gripa e Fongut, Rrasat e Mihalit, Lini i Janes, Hurdh e Osojit, Guri i Trashitun, Guri i Shushes, Astriçet, Guri i Ukut, Zhrumllaku, Gropat e Korsitit, Mali i Vogël, Ara e Dervishit, Livadhet e Buta, Shpati i Ndreçit, Pirgu, Bjeshka e Peles, Brushlla, Prroji i Fell, Grashticat, Ara e Gjat, Gurzit, Afushat, Lugu i Arushes, Balaveckat, Te N'viret Ujet, Ura e Nines, Guri i Nines, Rrahi i Stepces, Lugu i Zhypkave, Guri i Mbet Koles, Kroji i Stojes, Vorret e Kaurve, Vorret e Tujshve, Vorre Rimjanësh, Vorri i Kondes, Te Kulla, Vendi i Mixhes, Te Guri i Rades, Sahkalla, Ura e Merxhanit, N'Breg, Mas Bregu, Te Kroji i Poshter, Kroji Shtrepan, Mhalla e Hurdhës, Uji i Mijvecit, Kroji i Turbakut. Kroji i Xhamis, Vorret e Rimjanve, Vorret e Zhypkave, Vorret e Vashave, Te Kanallet, Ujt e Shuma, Livadhi i Piftit, Te Fuati, Ahi i Vetem, Grillishta, Te Hajrevica, Koder, Kukul, Prralluke, Shpella e Viljanit, Vorret e Kaurrve, Mullini Katundit, Kroji i Vogel, Kroji i Allamçes, Kisha e Momes, Vendi te Kisha, Mullini i Katundit, Te Koliba e Zhypit, Mullini i Budes, Kroji i Geges, Kroji i Kekes Hejd, Ura e Fahimit, Ura e Kishës, Ura e Kabashit, Rrasa e Haxhi Kokes, Sharra, Thonza, Dushku i Godkut, Agrada Lashit, Art e Lokes, Lomba e Myrtes, Brinja e Madhe, Brinja e Vogel, Brenjt e Zaes, Bregu i Botes, Kepi i Hoxhes, Vorri i Sallamonit, Ujet Kalar, Zholi, Vorri i Paditun, Porta e Zhypkave, Ujet kalar, Guri Pet, Te Mullinjt, Kroji i Xhamis, Kroji i Bregzajve, Kroji i Dushkut, Kroji i Bregut, Kajnaku i Madh, Kajnaku i Vogel, Guri i Maçitit, Guri i Rrethuet, Shpella me Dy Dyer, Shpella e Sojit, Shpella e Risit, Ura e Shullonit, Mali i Kulles, Llozi, Tallambaz, Mali i Shypes, Paralyp, Liniishtja e Çukes, Kamarica, Ara e Stanit, Livadhet, Leska, Sotka, Zabeli, Guri i Babës...

## **Përfundim**

Në fund fare më duhet të them se toponimet dhe emrat e fiseve/ familjeve të shkëputa nga vepra e Burim Prroit përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të të dhënave në raport me ato që mund të gjeni në monografinë e tij. Kjo më jep të drejtë të konstatoj se vepra në fjalë është më e plota që është shkruar gjer më sot mbi Lumën e Epërme. Në të autori ka lënë vite të tëra pune të lodhshme, duke kryer njëkohësisht detyrën e kronikanit të mirinformuar, të historianit serioz dhe të demografit, gjeografit e gjuhëtarit të shkathtë. Vetëm në sajë të këtyre tipareve, ai ia doli ta botojë librin me vlera të rralla, që, pa dyshim, do të jetë pikë e rëndësishme dhe e pakalueshme referimi për gjithë studiuesit e ardhshëm të historisë dinjitoze e të dhimbshme të kësaj krahine.